



## **VENDIM I PAPRANUESHMËRISË**

**Data e miratimit: 10 nëntor 2014**

**Numri i lëndës: 2014-09**

**Rifat Kadribasic**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 10 nëntor 2014, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaël METTRAUX, anëtar  
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetorit 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit me 9 qershor 2010,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar më 28 shkurt 2014.

## **II. FAKTET**

2. Siç janë parashtruar nga ankuesi, faktet e lëndës mund të përmblidhen si më poshtë.
3. Në vitin 1962, babai i ankuesit, RK, ka blerë një pjesë të pasurisë së paluajtshme nga një K.M. Toka ka qenë në posedim të familjes dhe kultivohej prej tyre qysh atëherë.
4. Në prill 2013, një H.K. ka vizituar ankuesin, duke pretenduar se toka i përkiste atij dhe duke paralajmëruar që ankuesi mos ta shfrytëzonte atë.
5. Më 19 qershor 2013, ankuesi ka parashtruar padi civile kundër K.M. dhe H.K. me Gjykatën Themelore të Pejës. Ai ka kërkuar një deklaratë të pronësisë së tij për pronën në fjalë.
6. Ankuesi pohon se që nga ajo datë, Gjykata Themelore nuk ka ndërmarrë asnje veprim. Në veçanti, asnje seancë nuk është mbajtur rrëth rastit të tij.

## **III. ANKESAT**

7. Ankuesi pohon se procedurat pranë Gjykatës Themelore të Pejës kanë qenë tejet të gjata. Ai kërkon nga EULEX-i t'i ndihmoj për të parandaluar padrejtësinë dhe mashtimin.

## **IV. LIGJI**

8. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar që të përdor instrumentet e të drejtave të njeriut, siç pasqyrohet në konceptin e llogaridhënieve së EULEX të datës 29 tetor 2009 mbi themelin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrotjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrotjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
9. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së punës.
10. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në drejtësi, policisë dhe doganë.
11. Paneli në disa raste ka konstatuar sipas rregullës 25, paragrafit 1, bazuar në konceptin llogaridhënës në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, se nuk ka

kompetencë as mbi fushën administrative e as mbi fushën juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të ndonjë gjykate, nuk ia humb atyre gjykatave karakterin e të qenurit pjesë e gjyqësorit të Kosovës (ndër të tjera shih *V kundër EULEX-it*, 2013-23, 26 maj 2014, par. 10; *E kundër EULEX-it*, 2012-17, 30 gusht 2013 at § 25; *Halili kundër EULEX-it*, 2012-08, 15 janar 2013, § 21; *Pajaziti kundër EULEX-it*, 2012-05, 4 tetor 2012 §§ 9-10). Paneli konstaton se nuk është argumentuar e leje më të jetë treguar se EULEX-i ka qenë në ndonjë formë i përfshirë në shkeljen e dyshuar të të drejtave të ankuesit.

12. Prandaj, çështjet që kanë të bëjnë me këtë lëndë nuk bien në kuadër të mandatit të Panelit siç saktësohet në rregullën 25, par. 1 të rregullores së punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it. Si pasojë, ato bien jashtë kompetencës së Panelit, siç saktësohet në rregullin 25 të rregullores së vetë të punës dhe të OPLAN-it të EULEX-it Kosovë.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzéri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrta këtë ankesë, gjen se ankesa bie jashtë kompetencave të Panelit sipas nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës, dhe

#### **SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese